

VENDIM
Nr.210, datë 10.4.2004

**PËR PROGRAMIN PILOT TË DELEGIMIT TË FUNKSIONIT TË INVESTIMEVE PËR
VITIN 2004, PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR, BASHKISË SË TIRANËS, PËR
TERRITORIN QË KJO BASHKI MBULON**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të nenit 13 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Delegimin e funksionit të investimeve në arsimin parauniversitar për vitin 2004, nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Bashkisë së Tiranës, për territorin që kjo e fundit mbulon.

2. Bashkia e Tiranës të përdorë fondin që Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka kualifikuar në buxhetin e vitit 2004, për investime të reja nga kjo bashki, në përputhje me kualifikimin buxhetor të investimeve, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Procedurat e prokurimit dhe lidhja e kontratave për objektet e përcaktuara në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, përjashtimisht nga procedurat e prokurimit të parashikuara në pikën 3.1 kapitulli III të vendimit nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore për mallra, shërbime dhe ndërtime”, të përfundojnë brenda datës 31.10.2004.

4. Ngarkohet Ministri i Arsimit dhe i Shkencës, Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit që në fund të vitit 2004 të bëjnë vlerësimin e këtij programi pilot.

5. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Ministri i Arsimit dhe i Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E OBJEKTEVE ARSIMORE DHE DETAJIMI I INVESTIMEVE NGA BUXHETI I SHTETIT PËR VITIN 2004

Nr. rend	Emërtimi i projektit	Kosto totale e projektit	Gjithsej 2004	Kërkohej për vitin 2004				
				Të ndarë në				
				Ndërtim montime	Studime projektim	Supervizim	Kolaudim	Shpronësime
	Investime gjithsej	530.740	288.000	220.153	28.216	4.631	0	35.000
	I. Investime për shkolla të mesme							
2.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Besnik Sykja”	88 359	41 404	37 656	3 068	680		
	Shuma "I"	88 359	41 404	37 656	3 068	680	0	0
	II. Investime për shkolla tetëvjeçare							
2.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Skënder Luarasi”	34 450	24 077	23 492	0	585		
3.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Qemal Ataturku”	40 037	27 981	27 244	0	737		
4.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Fan Noli”	56 761	26 692	24075	2142	475		
5.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “7 Marsi”	59 806	28 112	25 380	2 236	496		
6.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën "Dëshmorët e Lirisë”	52 786	23 515	21 070	2 001	444		
7.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Osman Myderizi”	45 262	21 314	19 161	1 762	391		
8.	Rikonstruksion dhe shtesë në shkollën “Kodër Kamëz”	33 042	15 591	13 950	1 343	298		
	Shuma "II"	322 144	167 282	154 372	9 484	3 426	0	0
	III. Investimin për kopshte							
1.	Rikonstruksioni i 10 kopshteve në qytetin e Tiranës	72 237	31 314	28 125	2 664	525		
	Shuma "III"	72 237	31 314	28 125	2 664	525	0	0
	IV. Pajisje me mjete mësimore							

	(Banga, karrige etj.)							
	Shuma "IV"	0	0	0	0	0	0	0
	V. Shpronësime për shkolla të reja							
		35 000	35 000					35 000
	Shuma "V"	35 000	35 000	0	0	0	0	35 000
	VI. Studime projekttime të reja							
		13 000	13 000		13 000			
	Shuma "VI"	13 000	13 000	0	13 000	0	0	0

